(Faqe 162-163)

## PUBLIKIM I ZYRES SË REGJISTRIT TREGTAR NË ANKARA

| | | |
|---|---|---|
| **Numri i Regjistrimit të Biznesit** | : | 31872 |
| **Emërtimi i Vjetër i Kompanisë** | : | LİMAK İNŞAAT SANAYİ ve TİCARET LİMİTED ŞİRKETİ (Sh.p.k) |
| **Emërtimi i Ri i Kompanisë** | | LİMAK İNŞAAT SANAYİ ve TİCARET ANONİM ŞİRKETİ |

Forma ligjore e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "LİMAK İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET LİMİTED ŞİRKETİ", e cila është e regjistruar në Zyrën tonë të Regjistrit Tregtar me numrin 31872, është shndërruar në "Shoqëri Anonime" me vendimin nr.130, datë 04.05.1998 të Asamblesë së Ortakëve të saj. Nga shqyrtimi procesverbalit dhe shtojcave që janë depozituar në Zyrën tonë vihet re se Statuti i shoqërisë anonime që është hartuar është vërtetuar nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë në datën 23.07.1998, për këtë arsye akti është regjistruar në datën 05.08.1998 në Zyrën tonë dhe teksti i Statutit të shoqërisë anonime shpallet në formën e shkruar më poshtë:

## STATUT
## i shoqërisë aksionere
## "LİMAK İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET ANONİM ŞİRKETİ"

**THEMELIMI:**

**NENI-1**

Mes personave fizikë dhe juridikë, emri, mbiemri, shtetësia dhe adresat e të cilëve janë shkruar më poshtë është krijuar një shoqëri anonime sipas dispozitave të Kodit Tregtar Turk mbi themelimin e shoqërive anonime duke ndryshuar formën ligjore të organizimit të shoqërisë tregtare me emërtimin "LİMAK İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET LİMİTED ŞİRKETİ", e cila është e regjistruar në Zyrën tonë të Regjistrit Tregtar me numrin 31872, mbështetur në nenin 152 të Kodit Tregtar Turk.

| Emri -Mbiemri i Themeluesit | Adresa zyrtare | Shtetësia |
|---|---|---|
| Nihat ÖZDEMİR | Çiçekdağı Sokak, No:4/9, G.O.P./Ankara | Turke |
| Sezai BACAKSIZ | Kırlangıç Sokak, No:26/3, G.O.P./Ankara | Turke |
| Ebru ÖZDEMİR | Çiçekdağı Sokak, No:4/9, G.O.P./Ankara | Turke |
| Mehmet Serhan BACAKSIZ | Kırlangıç Sokak, No:26/3, G.O.P./Ankara | Turke |

T.C. ANKARA 6. NOTERLİĞİ
Tel: (0312) 430 34 11 Fax: (0312) 430 79 12
08 Şubat 2021
ÇEVİRİ
№ 01749
ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT
DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Sedar Hüseyni TARAFINDAN Türkçe'DEN Arnavutça'YA ASLINA SADIK KALINARAK
İşbu çeviri Türkçe'den Arnavutça'ya aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme edilmiştir.
alle Yeminli Tercüme Bürosu — alle Certified Translation Agency — www.alle.com.tr

| | | |
|---|---|---|
| Batuhan ÖZDEMİR | Çiçekdağı Sokak, No:4/9, G.O.P./Ankara | Turke |
| Turhan Serdar BACAKSIZ | Kırlangıç Sokak, No:26/3, G.O.P./Ankara | Turke |

**EMËRTIMI I SHOQËRISË:**
**NENI-2**
Emërtimi i shoqërisë është: **"LİMAK İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET ANONİM ŞİRKETİ"**.

**NENI-3**

Qëllimi i krijimit dhe objekti kryesor i shoqërisë është si më poshtë:
a) Ndërtim, punë ndërtimore, kontraktore,
b) Prodhimi dhe tregtimi i materialeve, makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit,
c) Kërkim, hapje dhe administrim i minierave dhe guroreve,
d) Investim dhe administrim i komplekseve turistike,
e) Prodhim dhe tregtim i produkteve industriale,
f) Investim dhe administrim i institucioneve private arsimore dhe shëndetësore,
g) Transport tokësor, detar dhe ajror,
h) Tregtim i produkteve të hidrokarbureve,
i) Mund të bëjë import, eksport që ka të bëjë me objektin e aktivitetit të Shoqërisë, mund të marrë dhe japë të drejtën e përfaqësimit me degë, filial, agjenci etj,

Ne lidhje me përmbushjen e qëllimit të saj dhe çështjet që hyjnë në objektin e aktivitetit të saj gjithashtu Shoqëria;
a) Mund të blejë, shesë, marrë dhe japë me qira pasuri të lëvizshme, vendosë barrë ose heqë barrën mbi pasuritë e lëvizshme,
b) Ofron konsulencë, asistencë dhe përfaqësim (distributor),
c) Mund të marrë kredi në natyrë dhe të holla nga personat fizikë dhe juridikë dhe institucionet e tjera përkatëse rezident brenda dhe jashtë shtetit,
d) Mund të bëjë partneritet me personat fizikë dhe juridikë brenda dhe jashtë vendit, mund të tërhiqet nga partneriteti nëse do të jetë e nevojshme, mund të marrë pjesë (bëhet bashkëpronare) në kapitalin e këtyre partneriteteve, mund të blejë, shesë tituj si aksione dhe bono me kusht që të mos bëjë ndërmjetësim financiar (brokër),
e) Mund të nxjerrë patenta, licensa, të vendosë të drejta për markën, të drejta koncensionare, të drejta industriale si know-how, mund të transferojë, blejë, marrë e japë me qira të drejtat në natyrë,
f) Mund të bëjë ndërtim në këmbim të banesës (hyrjeve) duke lidhur kontratë me pronarët e truallit, qoftë në formën e kooperativës, qoftë duke u bërë bashkëpronar, mund të vendosë të drejta bashkëpronësie mbi këto ndërtime ose mund ta ndajë të drejtën e pronës. Shoqëria mund të shesë pasuritë e patundshme që janë në pronësitë saj, mund të blejë godina, banesa dhe dyqane që janë përfunduar pjesërisht ose plotësisht së ndërtuari dhe mund të bëjë shitjen e këtyre. Shoqëria vendos kufizime në

ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT
T.C.

alle Yeminli Tercüme Bürosu
alle Certified Translation Agency
www.alle.com.co

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Serdar Hüseyin ... TARAFINDAN ...'DEN ...'YE ASLINA SADIK KALINARAK ÇEVRİLMİŞ OLDUĞUNU ONAYLARIM

İşbu çeviri.........'den .........'ya aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme edilmiştir.

favor dhe disfavor të saj mbi pasuritë e veta të patundshme, i hipotekon dhe çliron ato nga barrët, gjithashtu Shoqëria mund të blejë tokë dhe këtë tokë të blerë mund ta kthejë në truall ndërtimi duke e ndarë atë në parcela dhe pastaj mund t'i shesë. Mund t'i bashkojë tokat dhe parcelat e blera, mund të braktisë pjesët e tyre që preken nga plani i zhvillimit dhe që shkojnë për rrugë dhe sipërfaqe të gjelbra. Mund të kryejë çdo lloj ndryshimi dhe korrigjimi që duhet bërë në lidhje me këtë çështje në drejtorinë e regjistrit të pasurive të patundshme dhe bashki etj.

Përveç punëve të përmendura më lartë, në rast se në të ardhmen do të kërkohet angazhim për punë të tjera të vlefshme dhe të nevojshme për Shoqërinë, atëherë Shoqëria do të mund t'i kryejë edhe këto punë vetëm pas propozimit të Bordit Drejtues dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme (e aksionarëve) dhe marrjes së vendimit në këtë drejtim.

Për zbatimin e këtij vendimi në cilësinë e ndryshimit të Statutit të Shoqërisë do të merren lejet e nevojshme nga Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

**SELIA, FILIALET DHE DEGËT E SHOQËRISË:**

**SELIA**

**NENI-4**

Selia e Shoqërisë është në adresën:
Hafta Sokak Nr.9, Gaziosmanpaşa/ANKARA.
Në rast të ndryshimit të adresës, adresa e re regjistrohet në Drejtorinë e Regjistrit Tregtar dhe shpallet në Fletoren Zyrtare të Regjistrit Tregtar të Turqisë dhe për ndryshimin e adresës njoftohet Ministria e Industrisë dhe Tregëtisë. Njoftimet që bëhen në adresën e regjistruar dhe të publikuar pranohet si njoftime që i janë bërë Shoqërisë. Për Shoqërinë pranohet si shkak i prishjes së saj në rast se nuk është regjistruar në adresën e re brenda afatit të caktuar megjithëse është larguar me kohë nga adresa e regjistruar dhe e publikuar më parë. Shoqëria mund të krijojë, hapë, themelojë filiale, degë dhe përfaqësi të saj brenda dhe jashtë vendit me vendim të Këshillit Administrativ (Drejtues) në përshtatje me Kodin Tregtar turk dhe dispozitat e legjislacionit përkatës duke njoftuar për këtë veprim edhe Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë.

ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT

**KOHËZGJATJA:**

**NENI-5**

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë 50 (pesëdhjetë) vjeçare. Kohëzgjatjen e aktivitetit të saj Shoqëria mund ta zgjasë dhe shkurtojë duke marrë leje ne Ministria e Industrisë dhe Tregtisë.

**KAPITALI THEMELTAR DHE LLOJI I AKSIONEVE:**

**NENI-6**

Kapitali i Shoqërisë është 1.500.000.000.000.-TL (Një trilion e peseqind miliardë) Lira Turke.
Kapitali është i ndarë në 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) aksione secila me vlerë nominale 25.000.000.-TL (njëzetë e pesë milionë Lira Turke).

alle Yeminli Tercüme Bürosu
www.alle.com.co
alle Certified Translation Agency

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Seydi Hüseyin TARAFINDAN TR'DEN ARN'YE ASLINA SADIK KALINARAK

T.C. ANKARA

İşbu çeviri TR'den ARN'ye aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme

08 Şubat 2021

Forma e pjesëtimit të këtij kapitalit dhe struktura e kapitalit të Shoqërisë është si më poshtë:

| Ortaku | Numri i Aksioneve | Vlera e Aksioneve (në Lira Turke) |
|---|---|---|
| 1. Nihat ÖZDEMİR | 29.400 | 735.000.000.000.-TL |
| 2. Sezai BACAKSIZ | 29.400 | 735.000.000.000.-TL |
| 3. Ebru ÖZDEMİR | 300 | 7.500.000.000.-TL |
| 4. Mehmet Serhan BACAKSIZ | 300 | 7.500.000.000.-TL |
| 5. Batuhan ÖZDEMİR | 300 | 7.500.000.000.-TL |
| 6. Turhan Serdar BACAKSIZ | 300 | 7.500.000.000.-TL |
| SHUMA TOTALE | 60.000 | 1.500.000.000.000.-TL |

Këto aksione që përbëjnë kapitalin themeltar të Shoqërisë janë të çliruara nga ndonjë marrëveshje e fshehtë dhe të gjitha të nënshkruara.

Pjesa në natyrë me vlerë 1.449.118.323.843.TL (Lira Turke) e kapitalit është kapital i ekuitetit i shoqërisë "LİMAK İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET LİMİTED ŞİRKETİ", e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Ankarasë me numrin 31872 dhe forma ligjore e të cilës është ndryshuar në përputhje me nenin 152 të Kodit Tregtar Turk. Ky kapital themeltar është përcaktuar nga Gjykata Tregtare e Shkallës së Parë të Ankarasë Nr.2 me vendimin nr.1998/1200, datë 03.07.1998 dhe me raportin e ekspertizës së datës 07.07.1998. Kapitalet e veta në fjalë të Shoqërisë në formën ligjore Sh.p.k janë transferuar së bashku me aktivin dhe pasivin në formën e re ligjore të Shoqërisë (shoqëri anonime).

E gjithë shuma 50.881.676.157.-TL, me të cilën është zgjeruar në të holla kapitali i Shoqërisë, do të shlyhen me para në dorë dhe në një herë të vetme brenda tre muajve që nga data e regjistrimit të formës së re ligjore të Shoqërisë.

Të gjitha certifikatat e aksioneve të Shoqërisë janë të emëruara. Nuk mund të emetohen certifikata të emëruara në emrin e poseduesit pa u shlyer më parë i gjithë kapitali themeltar i Shoqërisë. Aksionet që korrespondojnë me vlerë në natyrë të kapitalit nuk mund të transferohen tek dikush tjetër pa kaluar dy vite nga regjistrimi i Shoqërisë (me formën e re ligjore).

Që transferimi i kapitaleve të jetë i vlefshëm në raport me Shoqërinë është kushte që akti i transferimit të miratohet me shumicën e votave të Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues mund t'i shmanget aprovimit pa qenë i detyruar që të parashtrojë ndonjë arsye për këtë veprim të tij.

ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT

**KËSHILLI DREJTUES DHE MANDATI I ANËTARËVE**

**NENI-7**

Punët e Shoqërisë dhe administrimi i asaj bëhen nga një Këshill Drejtues (Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Kompanisë) i përbërë nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme (e Aksionerëve) në përputhje me dispozitat e Kodit Tregtar Turk.

Si anëtarë të parë të Këshillit Drejtues janë zgjedhur:

Nihat ÖZDEMİR

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Serdar Hüseyni TARAFINDAN TR 'DEN ARN 'YE ASLINA SADIK KALINARAK

İşbu çeviri TR 'den ARN 'ya aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme edilmiştir. Yeminli Tercüman

T.C. 1923 ANKARA NOTERLİĞİ

alle Yeminli Tercüme www.alle.com.tr Translation Agency

№01749



Sezai BACAKSIZ,
Ebru ÖZDEMIR

08 Subat 2021

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të zgjidhen e shumta për një mandat 3-vjeçar. Anëtarët e parë të Këshillit Drejtues janë zgjedhur për 3 (tre) vite. Anëtarët që u mbaron mandati kanë të drejtë rizgjedhjeje.

Asambleja e Përgjithshme (e aksionerëve) mund t'i ndryshojë anëtarët e Këshillit Drejtues sa herë që e shikon të nevojshme.

**PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË – NDARJA E DETYRAVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES**

**NENI-8**

Administrim i Shoqërisë dhe përfaqësimi i saj jashtë me të tretët është detyrë e Këshillit Drejtues. Që të gjitha dokumentet që do të lëshohen nga Shoqëria dhe kontratat që do të lidhen në emër të saj të jenë të vlefshme duhet që ato të bartin mbi vulën e Shoqërisë (që përmban emrin zyrtar të shoqërisë) nënshkrimin e personit apo personave që do të përcaktohen me Aktin e Autorizimit që do të nxirret nga Këshilli Drejtues, akt i cili i autorizon ata me të drejta për të përfaqësuar Shoqërinë.

**AUDITUESIT DHE DETYRAT**

**NENI-9**

Këshilli i Përgjithshëm zgjedh mes aksionerëve ose nga jashtë një ose më shumë se një auditues (mbikëqyrës) për një mandat e shumta trevjeçar.

Auditues i parë i Shoqërisë është zgjedhur për një afat njëvjeçar, Alaettin ŞAHİN me nënshtetësi turke, banues në adresën Mesa Çamyolu Sitesi, Konut II, C2 Blok B Giriş, Daire:9, Çayyolu, Ankara.

Audituesit kanë përgjegjësi për të kryer detyrat ashtu siç parashikohet në nenet 353-357 të Kodit Tregtar Turk.

**ASAMBLEJA E AKSIONERËVE**

**NENI-10**

Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm (Asamblesë së Aksionarëve) zhvillohen sipas parimeve të shkruara më poshtë:

**a) Mënyra e ftesës**

Asambleja e Aksionarëve thirret në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Në thirrjet e Asambleve të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme zbatohen dispozitat e neve 355, 365, 366 dhe 368 të Kodit Tregtar Turk.

**b. Koha e Thirrjes së Mbledhjes**

Mbledhjet e zakonshme bëhen e pakta një herë në vit dhe brenda 3 (tre) muajve nga mbyllja e periudhës financiare të Shoqërisë. Kurse mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen në çdo rast dhe kohë që e kërkojnë çështjet e shoqërisë. Mbledhjet thirren e zhvillohen sipas dispozitave të shkruara në ligj dhe në këtë Statut.

**c. Votimi dhe Caktimi i Përfaqësuesve**

Aksionerët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar që janë prezent në asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për një aksion kanë vetëm një të drejtë vote.

ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT

alle Yeminli Tercüme Bürosu
www.alle.com.co
alle Certified Translation Agency

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI
YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ
Serdar Hüseyin ... TARAFINDAN
TR ... 'DEN ... ALB ... 'YE
ASLINA SADIK KALINARAK

İşbu çeviri ... TR ... 'den
... ALB ... 'ya aslına sadık
kalınarak tarafımdan tercüme
edilmiştir.

№ 01749
18 Subat 2021

Në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve, aksionerët mund të përfaqësohen nga personat që do të emërojnë përveç aksionarëve të tjerë. Të deleguarit nga aksionerë të tjerë që njëherësh janë edhe aksionerë të shoqërisë kanë të drejtë që përveç të drejtës së votës që kanë për aksionet që zotërojnë të votojnë edhe për aksionet e aksionerëve që përfaqësojnë në mbledhje. Është esenciale që prokura e përfaqësimit në mbledhje të hartohet sipas normave të shkruara në Nenin-21 të Rregullores së Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë "Për Komisarët".

**d. Bërja e Diskutimeve në Mbledhje dhe Kuorumi për Marrjen e Vendimeve:**

Në mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë negociohet dhe merren vendime për çështjet që janë të shkruara në Nenin-369 të Kodit Tregtar Turk. Kuorumi dhe shumica për marrjen e vendimeve në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve i nënshtrohen dispozitave të Kodit Tregtar Turk.

**e- Vendi ku do të mbahen mbledhjet**

Këshilli i Përgjithshëm i mban mbledhjet në adresën e selisë së Shoqërisë ose në një vend të përshtatshëm në qytetin ku gjendet selia e saj.

**PRANIA E KOMISARIT NË MBLEDHJE:**

**NENI-11**

Prania e Komisarit të Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve, qofshin këto të zakonshme apo të jashtëzakonshme, dhe firmosja e procesverbaleve të mbledhjes nga ana e tij bashkë me personat përkatës është e detyrueshme. Nuk janë të vlefshme vendimet që merren në mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve që do të zhvillohen në mungesë të Komisarit.

**PUBLIKIMET**

**NENI-12**

Njoftimet që Shoqëria duhet të publikojë sipas kërkesave të ligjit bëhen në bazë të dispozitave të Nenit-37 të Kodit Tregtar Turk, por duke rezervuar dispozitat e paragrafit-4 të këtij neni. Publikimet bëhen e pakta 15 (pesëmbëdhjtë) ditë më parë duke i botuar ato në një gazetë që del në lokalitetin ku gjendet selia e Shoqërisë.

Vetëm se është e detyrueshme që publikimet që kanë të bëjnë me thirrjet për mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve sipas dispozitave të nenit 368 të Kodit Tregtar Turk duhen bërë e pakta 2 (dy) javë më parë se data e publikimit dhe mbajtjes së mbledhjes.

Për publikimet lidhur me reduktimin e kapitalit dhe likuidimin e shoqërisë zbatohen dispozitat e neneve 397 dhe 438 të Kodit Tregtar Turk.

ANKARA 6. NOTERİ
İmzaya Yetkili Başkatibi
MESUT POLAT

**VITI FINANCIAR**

**NENI-13**

Periudha ushtruese për Shoqërinë është viti kalendarik. Viti financiar fillon ditën e parë të muajit janar dhe përfundon në ditën e fundit të muajit dhjetor. Vetëm se viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e themelimit të saj dhe mbaron ditën e fundit të muajit dhjetor të atij viti.

alle Yeminli Tercüme Bürosu
alle Certified Translation Agency
www.alle.com.co

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Serdar Hüseyin TARAFINDAN ALN 'DEN TR 'YE ASLINA SADIK KALINARAK ÇEVRİLMİŞ OLDUĞUNU ONAYLARIM.

İşbu çeviri TR 'den ALN 'ya aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme edilmiştir.
Yeminli Tercüman

T.C. 1923 ANKARA 6. NOTERLİĞİ

№ 017 49
08 Subat 2021

**PËRCAKTIMI DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT:**
**NENI-14**

Pjesa që ka mbetur, pasi kemi zbritur nga të ardhurat vjetore bruto të llogaritura në fund të periudhës financiare (ushtrimit të mbyllur) të gjitha shpenzimet e paguara ose të zotuara, shumat për amortizimin dhe zotime të ndryshme të mundshme përbën fitimin neto të Shoqërisë. Çdo vit 5% e fitimit vjetor neto veçohet për rezervat e domosdoshme. Nga shuma që ka mbetur një pjesë që korrespondon me 5% të pjesës së paguar të aksioneve të nënshkruara lihet mënjanë si divident i parë dhe nga shuma që mbetet shlyhen sipas ligjit borxhet e Shoqërisë.

Pjesa e mbetur shpërndahet në formën dhe kohën që do të caktojë Asambleja e Aksionarëve.

Në bazë të pikës-3 të paragrafit të dytë të Nenit-466 të Kodit Tregtar Turk nga shumat që veçuar për t'u shpërndarë themeluesve, anëtarëve të Këshillit Drejtues, drejtuesve dhe nëpunësve, shuma që është vendosur t'u shpërndahet aksionarëve si aksion e dividentit të dytë dhe institucioneve pjesëmarrëse mbahet 10% e cila i shtohet provizioneve për fondet rezervë.

**REZERVAT**
**NENI-15**

Për rezervat që do të vihen në dispozicion nga Shoqëria do të zbatohen dispozitat e neneve 466 dhe 467 të Kodit Tregtar Turk.

**DISPOZITA LIGJORE:**
**NENI-16**

Për çështjet që nuk janë të shkruara në këtë Statut zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Tregtar Turk.

**TAKSA E VULËS**

Nen i përkohshëm: Taksa e vulës që duhet paguar në lidhje me miratimin e këtij statuti, do të paguhet nga ana jonë brenda tre muajve në zyrë përkatëse tatimore.

Aksionerët themelues: (emër-mbiemër-nënshkrimet)

1. Nihat Özdemir (Nënshkrimi)
2. Sezai Bacaksız (Nënshkrimi)
3. Ebru Özdemir (Nënshkrimi)
4. Mehmet Serhan Bacaksız (Nënshkrimi)
5. Batuhan Özdemir (Nënshkrimi)
6. Turhan Serdar Bacaksız (Nënshkrimi)

T.C. ANKARA 6. NOTERİ İmzaya Yetkili Başkatibi MESUT POLAT ANKARA NOTERLİĞİ

(10/A)(5/E-10412)

**KOPJE AUTENTIKE**
14.01.2021
Miratuar nga: Arzu ERDEM
Në Emër të Drejtorit të
Gazetës Zyrtare të Regjistrit Tregtar të Turqisë
//Nënshkrimi//

**VULA**
DREJTORIA E GAZETËS ZYRTARE
TREGTARE TË TURQISË
ANKARA
1957

alle Yeminli Tercüme Bürosu www.alle.com.tr

DAİREMİZDE KİMLİĞİ SAKLI YEMİNLİ TERCÜMANIMIZ Serdar Hüseyin ... TARAFINDAN ...'DEN ...'YE ASLINA SADIK KALINARAK

İşbu çeviri ... TR ...'den ... ALB ...'ya aslına sadık kalınarak tarafımdan tercüme edilmiştir. Yeminli Tercüman

**APOSTILLE**

**( Convention de La Haye du 5 Octobre 1961 )**

1. Ülke/Country/Pays/Staat TÜRKİYE - LA TURQUIE

İşbu resmi belge/This public document/Le présent acte public/Dieses zeugnis wurde

2. Mesut POLAT tarafından imzalanmıştır./Has been signed by/a été signé par/durch ... unterschrieben

3. İmzalayanın sıfatı BaşKatip'dır./Acting in the capacity of/Agissant en qualité de/Titel des Unterzeichneten

4. ANKARA 6 NOTERLİĞİ 'nin mühür/damgasını taşımaktadır-bears the seal/stamp of-/est revétu du sceau/timbre de-trägt Siegel/Stempel von

**TASDİK / CERTIFIED / ATTESTE / BEGLAUBIGUNG:**

5. Mamak Kaymakamlığı' da/at/à/in

6. 8.02.2021 günü/the/le/Am

7. V.H.K.İ Fatih ÖZTÜRK tarafından/by/par/durch den/die

8. No : 11735 ile tasdik edilmiştir./No:/sous No:/unter Nr.

9. Mühür - Damga/Seal-stamp/Sceau-timbre/Siegel-Stempel

.............

10. İmza/Signature/Signature/Unterschrift:

.............

